

Mundësi për aplikim në thirrjen për Grante “WBF Move” të shpallur nga Fondi i Ballkanit Perëndimor

Fondi i Ballkanit Perëndimor (WBF) ka shpallur thirrjen për Grante nën Skemën e Granteve të Mobilitetit “WBF Move”, që synon të nxisë bashkëpunimin rajonal dhe mobilitetin brenda Rajonit të Ballkanit Perëndimor. Kjo iniciativë synon të fuqizojë individët në sektorë të ndryshëm duke ofruar mbështetje financiare për projekte që promovojnë bashkëpunimin dhe shkëmbimin. Skema e Granteve WBF Move mbështetet nga Qeveria Zvicerane. Në këtë thirrje mund të aplikojnë edhe stafet e bashkive me projekte bashkëpunimi dhe shkëmbimi rajonal.

Synimi i thirrjes:

Qëllimi i Skemës së Granteve të Mobilitetit është të nxisë lidhjet midis njerëzve dhe të mbështesë rritjen personale dhe profesionale të individëve në Ballkanin Perëndimor. Ajo synon të zhvillojë bashkëpunimin rajonal përmes shkëmbimeve ndërkulturore dhe profesionale, duke inkurajuar përfshirjen dhe diversitetin në rajon.

Kush mund të aplikojë:

Aplikantët duhet të jenë individë mbi 18 vjeç dhe të kenë shtetësi nga një prej 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, dhe Serbia). Duhet të jenë të angazhuar në një organizëm publik ose privat në një nga këto vende.

Këto grante janë të hapura për kategori të ndryshme, përfshirë stafin akademik, studiuesit, studentët, aktivistët e shoqërisë civile, nëpunësit publikë, gazetarët, artistët, sportistët, etj.

Fushat e veprimit të thirrjes:

Granteve të Mobilitetit për Individët synon në mënyrë specifike:

- Të përmirësojë dialogun ndërkulturor dhe shkëmbimin e njohurive ndërmjet ekspertëve dhe profesionistëve nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.
- Të mbështesë mobilitetet profesionale (d.m.th., udhëtime rajonale për qëllime profesionale) të artistëve, profesionistëve të kulturës, akademisë, gazetarëve, aktivistëve.
- Të mbështesë krijimin e lidhjeve ndërmjet profesionistëve për të mbështetur bashkëpunimin rajonal.

Fushat prioritare të ndërhyrjes për individë përfshijnë:

- Artin dhe Kulturën,
- Arsimin dhe Shkëmbimet Shkencore,
- Mediat,
- Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ndryshimet Klimatike,
- Zhvillimin Ekonomik dhe Inovacionet Digjitale,
- Ndërtimin e Paqes, dhe Sportin.

Aktivitetet e pranueshme janë studimet dhe shkëmbimet kërkimore, trajnime dhe ndërtim kapacitetesh, praktika pune, pjesëmarrje në konferenca, projekte artistike dhe kulturore, dhe projekte sportive.

Fushat e aktiviteteve:

- Shkëmbime Studimi ose Kërkimi.
- Trajnime dhe Ndërtim Kapacitetesh.
- Praktika dhe Vendorsje në Pune.
- Pjesëmarrje në Konferenca dhe Evente.
- Projekte Artistike dhe Kulturore.
- Zhvillimi i Politikave dhe Avokimi.
- Kërkime në Terren dhe Mbledhje të Dhënash.
- Projekte dhe Partneritete Bashkëpunimi.
- Angazhimi në Komunitet.
- Projekte dhe Shkëmbime Sportive.

Mobilitetet dhe periudha:

Një projekt mund të përfshijë deri në tre mobilitete, dhe periudha maksimale e qëndrimit është deri në 6 muaj. Projektet duhet të fillojnë jo më herët se 1 shkurti 2025 dhe të përfundojnë deri më 31 korrik 2025.

Buxheti për thirrjen dhe për projekt:

Fondi mbulon deri në 100% të kostove të pranueshme, dhe shuma maksimale për grant është 3,000 EUR për projekt. WBF do të mbështesë maksimumi një projekt mobiliteti për aplikant në vit. aplikimet e kryera në një thirrje të mëparshme nuk do të merren parasysh.

Kostot e pranueshme:

Kostot e pranueshme përfshijnë shpenzimet e udhëtimit, akomodimit (jo më shumë se 65 EUR për natë), dieta (maksimumi 40 EUR për ditë), sigurimi shëndetësor, tarifat e regjistrimit, dhe kostot shtesë për aplikantët me nevoja të veçanta.

Si bëhet aplikimi:

Aplikimi bëhet përmes sistemit online të WBF-së. Aplikantët duhet të regjistrohen në platformën e dedikuar dhe të plotësojnë formularin e aplikimit dhe buxhetin përkatës

Afati i fundit për aplikim:

15 Nëntor 2024, ora 17:00.

Linku i thirrjes:

<https://westernbalkansfund.org/wbf-move-call-for-proposals-is-open/>